**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**NOTERE REZARTA B. KOÇI**
Nr. 6554 Rep.
Nr. 2136 Kol.

**AKT THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**SHOQERISE "COMFORT DEVELOPMENT" sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më 11.10.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta B. Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën "Bulevardi Zogu i Parë", pranë "Ministrisë së Drejtësisë", Njësia Bashkiake Nr. 9, u paraqit personalisht:

**THEMELUESIT:**
**Z.Andon Dhima,** i biri i Foto, me datëlindje 27.01.1969, lindur ne Delvine,Sarande dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personal G90127097T.
**Z.Alban Efthimi,** i biri i Romeo , me datëlindje 13.10.1970, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personal H01013093A.
**Z.Andi Efthimi,** i biri i Romeo, me datëlindje 04.01.1978, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personalH80104093K.
**Z.Olsi Efthimi,** i biri i Romeo , me datëlindje 04.01.1978, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personal H80104094S.
**Z.Altin Premti,** i biri i Veli, me datëlindje 30.08.1971, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr personal H10830113G.

hartojmë këtë statut te shoqërisë " **"COMFORT DEVELOPMENT" sh.p.k"** Sh.p.k, mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë.

**NENI 1**

Te krijoj shoqërinë tregtare me Përgjegjësi te Kufizuar " **"COMFORT DEVELOPMENT" sh.p.k"** Sh.p.k., e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

Kjo shoqëri do te emërtohet **"COMFORT DEVELOPMENT" sh.p.k**

**NENI 2**

Shoqëria "**"COMFORT DEVELOPMENT" sh.p.k** " sh.p.k. do te ketë Qendrën ne Rr. " Muhamet Gjollesha", Pallati AN.NIK, Prane Stadiumit "DINAMO", Kati 8, Ap 28, Tiranë dhe do te ushtroje veprimtarinë e saj private.
Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore mbi 10 vjet.

**NENI 3**

**Fusha e veprimtarisë së shoqërisë do të jenë:**
Projektimin, ndertimin, ristrukturimin dhe modernizimin e objekteve civile, industriale dhe te sherbimit. Realizimin dhe drejtimin e strukturave te tilla si hotel, bar , restorante vetesherbime,ofiçina,pjese kembimi,transporte detare dhe tokesore.Prodhimin dhe perdorimin e shitjeve te materialeve inerte, trajtim dhe perpunim i mbetjeve te çdo lloji dhe skarcitete te produkteve, hapjen e linjave te inerteve rikonstruksioneve te çdo lloji.Import,eksport,grumbullim dhe tregtim skrapi.Aktivitet minerar:grumbullim dhe tregetimin,transport dhe ndermjetesim per tregje te mineraleve.Shfrytezimi dhe perpunim i lendes

drusore,grumbullim,perpunim dhe shitje qymyr druri..Ndertim dhe montim te impianteve per prodhimin e energjise nga burime te ndryshme,impiante elektrike per centrale dhe prodhim te transformatoreve,montim i linjave te tensionit te larte dhe te ulet.Perdorimit te lendeve plasese e shperthyes.

Çdo aktivitet te ligjshem tregtar qe lidhet me cfaredolloj pasurie te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne blerjen, shitjen, transferimin, ndertimin, nen-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhenien me qira, leasing e pasurive te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, dhenien e perfitimin e cdo te drejte apo privilegji ne lidhje me keto pasuri

Te operoje ne sektorin e Import,eksport,tregti me shumice e pakice e te te gjitha mallrave industriale, ushqimore, fruta-perime, blegtorale, pije te ndryshme alkoolike e jo alkoolike e freskuese, veshmbathje, materiale ndertimi, pjese kembimi automjete, makinerive, mobiljeve, bime medicinale, lende drusore, plastike duralumini, materiale metalike, elektrike, telefonike, metale e minerale, lende e pare, shufra, profile si dhe prodhime te tjera metalike te llojeve e tipave te ndryshem etj. Pllaka dhe pajisje hidraulike, lendeve te para per prodhimin e mobiljeve, makinerive per prodhimin dhe perpunimin e lendes drusore si dhe pjese kembimi per to, mobilieve dhe elementeve te tyre, lendeve te para e materialeve te ndertimit, duhan, cigare, konfeksione e tekstile , kepuce te çdo lloji, galanteri dhe artikuj lekure si dhe lende te pare per industrine e perpunimit te lekures, paisje kancelarie, artikujve te kozmetikes, dentare, optike, higjeno sanitare dhe paisje e vegla mjeksore te sherbimit human e veterinar. Plehra kimike e inorganike per bujqesine si dhe artikuj e lende te para per industrine kimike e ate organike..

Aktivitet te ligjshem tregtar qe lidhet me import-eksport dhe tregtim te auto-veturave. Aktivitet te ligjshem tregtar qe lidhet me import-eksport dhe tregtim te produkteve kozmetike dhe farmaceutike. Aktivitetin e mbushjes se shisheve me uje dhe tregtimin e tyre. Kerkime te tregut, organizoje rrjete tregtare, nenshkruaje kontrata agjensie, te marre dhe te jape agjensi, komisione, perfaqesime dhe mandate. Shoqeria mund te kryeje per shoqerite me kuota ne pjesemarrje dhe te lidhura sherbime tekniko-administrative dhe koordinimi, sherbime promovimi dhe marketingu dhe cdo aktivitet per zgjidhjen e problemeve ne fushen administrative. Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme dhe hipotekore qe lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, te jape garanci te treteve si edhe te kete pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsociume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise.

te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi.

Per me teper, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga legjislacioni ne fuqi.

Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin vendim për të shtuar objektin e veprimtarisë së shoqërisë "

**NENI 4**

Shoqëria mund te shtoje vendqëndrimin, ndryshoje emertimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj, me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete: **10.000 Leke** (dhjetë mije lekë) e përbërë nga 5 (pese) kuota dhe i perket ortakëve si me poshte.

| | |
|---|---|
| 1. ANDON DHIMA | me 50 % te kuotave = ( 5.000 leke) |
| 2. ALBAN EFTHIMI | me 30% TË KUOTAVE = ( 3.000 LEKË) |
| 3. ANDI EFTHIMI | me 5 % TE KUOTAVE = ( 500 LEKË) |
| 4.OLSI EFTHIMI | me 5 % TË KUOTAVE = (500 LEKË) |
| 5. ALTIN PREMTI | me 10 % të kuotave = (1.000 lekë) |

**NENI 6**

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku, por ne asnjë rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortaket e tjerë te rrisin kuotën e tyre ne kapitalin e shoqërisë.

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak te humbjeve te vërtetuara ne dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes se parakohshme te shoqërisë. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlere jo me te vogël se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

**NENI 7**

Ortaku qe ka ndërmend t'u shesë te treteve kuota te kapitalit te tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet te njoftoje me pare

ortaket e tjerë te shoqërisë, te cilët kane te drejtën e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi te mëtejshme ortaket do ti referohen dispozitave te parashikuara ne Ligjin "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008.

**NENI 8**

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori .

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

**NENI 9**

Administratore te shoqërisë jane **Z.Andon Dhima dhe Z.Alban Efthimi** te cilet do te kryejne bashkarisht veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise .

Cdo veprim i kryer vetem nga njeri prej administratoreve eshte absolutisht i pavlefshem ne se nuk eshte percaktuar ndryshe me vendim Asambleje apo me rregullore te brendeshme te shoqerise. Administratoret zgjidhen **për nje afat 5 vjet** me te drejte ripërtëritjeje.

**NENI 10**

Vendimet e Asamblesë janë te vlefshme ne se janë miratuar nga ortaket e saj sipas dispozitave te Ligjit Për Shoqëritë Tregtare ne lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave ne kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes se Asamblesë se Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme, kompetencave te ortakeve dhe marrjes se vendimeve do te bazohet ne statutin e shoqërisë si dhe ne Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

**NENI 11**

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar te shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do te shënohet kontributi i ortakut te vetem. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave te ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave te tjera financiare, te domosdoshme për veprimtarinë normale te saj.

**NENI 12**

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do te ndahet ndërmjet ortakut te vetem mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezervës ligjore deri ne përmbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqërisë.

**NENI 13**

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi te ketë marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua ne katër dokumente origjinale me fuqi te barabarte secila, për t'u depozituar ne QKR, Degën Rajonale Tatimore, zyrën e noterisë si dhe një kopje ruhet ne dokumentacionin baze te shoqërisë.

Ky akt Themelimi redaktohet në katër kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, i lexohet të përfaqësuarit, i cili e kupton, pranon përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruan atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" *(i ndryshuar)*. Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 "Për Noterinë" *(i ndryshuar)*.

**ORTAKET**

Andon Efthimi

Alban Efthimi

Andi Efthimi

Olsi Efthimi

**NOTERE**